



Kampionati Kombëtar – Karting Endurance 2023

Rregullore e Përgjithshme

Organizimi:

1. **Kampionati Kombëtar i Karting Endurance 2023** do të zhvillohet sipas kalendarit të publikuar nga Organizatori.
2. Datat e garave mund të ndryshojnë; për çdo ndryshim do bëhet një njoftim paraprak në kohë të përshtatshme.
3. Çdo garë do të zhvillohet me dy sesione: Provat Kualifikuese dhe Gara.
4. Pjesëmarrësit do të jetë një ekip i përbërë si vijon:
 - 4.1 1 Përfaqesues Ekipi
 - 4.2 3 Pilotë garues
5. Pilotët duhet të jenë të paktën 17 vjeç (të vitit të lindjes jo më vonë se viti 2005)
6. Për të marrë pjesë në Provat Kualifikuese, garuesit duhet të regjistrohen brenda afatit të përcaktuar. Regjistrimi është i hapur për të gjithë dhe bëhet përkundrejt një **pagese prej 2000 ALL per kualifikueset dhe 2500 ALL per Pilot për Garë.**
7. Në Prova garuesit do të kryejnë 1 xhiro formatimi dhe 5 **xhiro të kronometruara** në pistë nga të cilat koha më e shpejtë e realizimit të xhiros do të shërbejë si kohë e cila do të përcaktojë rendin e nisjes.
8. Zhvillimi i provave kualifikuese do të jetë i hapur nga dita e shpalljes së dates së garës deri në fundin e kohës së punës së ditës së enjte para zhvillimit të garës.
9. Për të marrë pjesë në garë, **të gjithë garuesit duhet të pajisen me Licencë Kartingu të lëshuar nga ACA.** Aplikimi për pajisjen me Licencë mund të bëhet në ditët e garës. Mos-pajisja me Licencë nënkupton mospjesëmarrjen në garë.
10. Rezultatet e Provave do të shpallen menjëherë pas përfundimit të Kualifikueseve.
11. **FINALE**
 - 11.1 Radha e nisjes në garë do të përcaktohet nga kombinimi i tre kohëve më të shpejta të 3 garuesve të të njëjtit ekip të regjistruara në kualifikuese.
 - 11.2 Ekipet e renditura sipas kohëve të regjistruara në kualifikues, do të marrin pjesë në garat e kampionatit që do të zhvillohet në datat sipas kalendarit të shpalluar tek Kartodrom Tirana.
12. **Formati i Finales do të jetë:**
 - 12.1 Makinat go-kart për garimin do të sigurohen nga organizatori
 - 12.2 Nisja e finales do të zhvillohet ditën e shtunë ora 14:00;
 - 12.3 Të gjithë ekipet pjesëmarrëse në garë do të pajisen me një makinë e cila do të përdoret nga 3 pilotët e ekipit.
 - 12.4 Caktimi i makinës për çdo ekip do të bëhet në mënyrë të rastësishme nga organizatori
 - 12.5 Të gjithë garuesit gjatë garës duhet të kenë pajimet si vijon:
 - i Doreza të cilat i mbulojnë duart plotësisht
 - ii Këpucë që mbulojnë kyçet e këmbës
 - iii Kostum garimi i cili mbulon gjithë trupin
 - iv Kokore për mbrojtjen e kokës nga goditjet



Finale – Në finale do të garojnë deri 10 ekipe në të njëjën kohë për 30 minuta. Koha maksimale e garimit për pilot është 10 minuta. Fitues do të shpallet ekipi i cili do të ketë përshkruar distancën më gjatë në përfundimin e kohës 30 minuta.

13. Gjatë ditës së garës, garuesit duhet të paraqiten në pistë **1 orë** përpara nisjes së garës (ora 13:00) për kontrollet administrative.
14. Zyrtaret e Gares:
 - 14.1 Gjyqtar i Garës – Percaktohet nga organizatori
 - 14.2 Drejtor i Garës – Percaktohet nga organizatori
 - 14.3 Sekretar i Garës – Percaktohet nga organizatori
 - 14.4 Marshalle – Percaktohet nga organizatori
15. Pikët e fituara në cdo garë do të shërbejnë për përcaktimin e renditjes së përgjithshme të Kampionatit.
16. Pas çdo gare do të ketë një ceremoni për shpalljen e fituesve. Fituesit e tre vendeve të para do të vlerësohen me cmime pas çdo gare.
17. Para nisjes së garës do të ketë një mbledhje të shkurtër me garuesit dhe stafin për sqarimin e çdo paqartësie apo komunikimin e informacioneve të nevojshme.

Rregullore e Regjistrimit në Garë:

1. Regjistrimi duhet të kryhet brenda afateve të përcaktuara nga organizatori të Provave Kualifikuese dhe sesionit të Garës Zyrtare.
2. Tarifa e regjistrimit në garë është prej 2000 ALL per kualifikueset dhe 2500 ALL per Garen per person.
3. Garuesi duhet të paraqesë **kartën e identitetit**.
4. Të dhënat personale të garuesit që do të regjistrohet, do të përdoren vetëm për çështje sportive në lidhje me **Kampionatin Kombëtar të Karting Endurance**.

Rregullore e Para-garës:

1. Garuesi duhet të pajiset me **Licencë Kartingu**, të lëshuar nga **Automobile Club Albania ACA**.
2. Garuesit duhet të respektojnë **rregullat e etikës** me stafin dhe garuesit e tjerë në ambjentet e garës.
3. Për çdo **paqartësi** apo **ankesë**, ekipet do të caktojnë një përfaqësues i cili duhet të komunikojë me vetëm me organizatorin ose një person të tretë të deleguar prej tij.
4. Të gjithë garuesit duhet të qëndrojnë në vëndet e paracaktuara nga stafi drejtues, përpara dhe gjatë garës.
5. **Ndalohe** rreptësisht **hyrja në pistë** pa autorizimin e zyrtarëve të garës.

Rregullore e Garës:

1. Lexoni artikullin “**Rregullore e Garës**” dhe firmoseni atë përpara se të futeni në garë.
2. “**Rregullorja e Garës**” shërben si kontratë midis organizatorit dhe garuesit për mbarëvajtjen e garës dhe nëse nuk zbatohet nga ana e garuesit do të ketë penalitete të cilat vendosen sipas rastit të shkeljes (të cilat renditen në Rregulloren e Garës).



- Garuesi ka të drejtë të marrë pjesë në garë pasi e ka **lexuar, kuptuar dhe firmosur** Rregulloren e Garës.

Kategoritë:

- Kategoria e përgjithshme:** Garuesit individual të cilët shënojnë pikë përgjatë gjithë kampionatit. Garuesi me më shumë pikë pas garës së gjashtë do të shpallet KAMPION. Në rast rezultati të barabartë, fitues do të shpallet piloti me më shumë gara të fituara.

Klasifikimi dhe pikët:

- Pikët në renditjen përfundimtare të garës për ekipet do të jenë si vijon:

Vendi	1	2	3	4	5	6
Pike	10	8	6	4	2	1

Flamujt:

- Flamuri kombëtar: Fillimi i garës (sesionit). Pilotët fillojnë garën.
- Flamuri i gjelbër: Pista e lirë. Pilotët lejohen të vazhdojnë garimin normalisht.
- Flamuri i verdhë: Situatë e rrezikshme, ngadalësohet shpejtësia. Nuk lejohen parakalimet.
- Flamuri i kuq: Garë e ndërprerë. Të gjithë garuesit kthehen në bokse.
- Flamuri blu: Tregon që po të ndjek një garues më i shpejtë, i cili nuk po garon në të njëjtën xhiro. Nuk lejohet të pengohet garimi i pilotit që të ndjek.
- Flamur bardhë e zi (i ndarë diagonalisht): Paralajmërim për sjellje jo korrekte gjatë garimit. Pasohet nga flamuri i zi.
- Flamuri i zi: Përrjashtim nga gara. Pavarësisht sesionit piloti që merr flamurin e zi automatikisht renditet i fundit për atë garë.
- Flamuri i bardhë: Piloti futet në xhiron e fundit.
- Flamuri bardhë e zi (me kuadratë): Përfundimi i garës.

Ndarja e karteve:

- Kartet janë të siguruar nga Kartodrom Tirana dhe i caktohen pilotëve për përdorim gjatë garave. Asnjë ekip nuk do të lejohet të bëjë ndërhyrje tek kartet. Ndërrimi i pjesëve, lubrikantëve apo çdo lloj punimi tjetër mbi kart është i ndaluar për pilotët apo pjesëtarët e ekipeve, duke përfshirë edhe ndryshimin e presionit të gomave. Kjo lloj sjellje rezulton në përjashtim nga gara.
Organizatori kujdeset që performanca e karteve të jetë sa më e njëjtë të jetë e mundur për të siguruar një garë sa më të drejtë.
- Caktimi i karteve: Bëhet në mënyrë të rastësishme gjatë kualifikueseve në varësi të radhës së regjistrimit të ekipeve. Gjatë sesioneve të garave ekipet do të bëjnë përzgjedhjen e karteve sipas baterive në mënyrë të rastësishme.



Ndryshimi i pilotëve:

1. Ndalimi i karteve do të bëhet në zonat e përcaktuara nga organizatori
2. Nuk lejohet ndalimi i karteve njëkohësisht për ndryshimin e pilotit pa miratimin e organizatorit
3. Nuk lejohet përshpejtimi në korsinë e ndalimit të karteve
4. Zëvendësimi i pilotit do të bëhet me kartin e fikur

Sjellja e pilotit gjate gares:

1. Pilotët duhet të paraqiten dhe të kenë përfunduar regjistrimin minimalisht 15 min para fillimit të sesionit (kualifikuese apo garë). Mosparaqitja në kohë do të sjelli penalizimin e pilotit në rezultatet përfundimtare. Herën e parë merr paralajmërim, herën e dytë penalizohet me një vend në renditje ndërsa herën e tretë penalizohet me pesë vende.
2. Piloti duhet të jetë gati i pozicionuar në kart për nisjen e gares sipas njoftimit te organizatorit, në rast se nuk paraqitet në kohë, humbet të drejtën e pozicionit dhe nisjet i fundit brenda baterisë.
3. Pilotit nuk i lejohet të prekë asnjë pjesë tjetër të kartit, me përjashtim të timonit dhe pedaleve. Çdo përpjekje për të rritur performancën e kartit duke përdorur duart apo këmbët në një mënyrë të papërshtatshme do të ndërshkohet nga drejtuesit e garës.
4. Piloti që bën gjeste agresive, fillimisht do t'i tregohet flamuri paralajmërues, në rast përsëritje do të përjashtohet nga gara (flamuri i zi), duke rezultuar në skualifikimin e ekipit.
5. Piloti duhet t'i bindet të gjitha udhëzimeve të zyrtarëve të garës. Në rast mos respektimit të sinjalizimeve apo flamujve, drejtori i garës merr masën ndërshkuese në varësi të rëndësisë së shkeljes sipas interpretimit.
6. Çdo lloj agresioni verbal apo fizik midis pilotëve brenda apo jashtë ambjenteve të pistës së kartingut do të rezultojnë në penalizime nga ana e drejtorit të garës në varësi të vendimit të marrë. Ndërshkimet e mundshme janë paralajmërimi, pezullimi për 1 ose më shumë gara dhe/ose përjashtimi nga kampionati.
7. Parakalime të gabuara do të konsiderohen rastet kur piloti që parakalon:
 - Godet me ose pa qëllim pjesën e pasme të kartit përpara duke e zhvendosur nga trajektorja normale;
 - Godet pjesën anësore të kartit përpara duke e bërë rrotulluhet apo të manovrojë rëndë për shkak të shtytjes;
 - Frenon jo normalisht duke goditur kartin e parakaluar në pjesën anësore, duke e shtyrë atë jashtë trajektores;Pilotët që kryejnë parakalime të gabuara janë të detyruar të detyruar t'i lëshojnë vendin kartit të parakaluar brenda kthesës së ardhshme, në të kundërt do të penalizohen.
8. Mbrojtje të gabuara do të konsiderohen rastet kur piloti:
 - Lëviz më shumë se një herë anash në pjesët e drejta të circuitit;
 - Nuk respekton faktin që piloti që e ndjek është i pozicionuar me goma në mesin e kartit të tij dhe zhvendoset anash duke e bërë të përplasat me barrierat anësore ose thjeshtë nuk e lejon të përfundojë parakalimin. Në këtë rast piloti që mbrohet do të ndëshkohet në varësi të rëndësisë së veprimit të tij.
9. Nëse një pilot po garon shumë ngadalë, duke vënë në rrezik garuesit e tjerë, do të skualifikohet nga gara. Drejtori i garës do të konsiderojë si rrezik për garuesit këdo që shënon xhiro të ngadalta të përsëritura. Nëse performanca e ngadaltë do të përsëritet në një garë të dytë, piloti do të përjashtohet nga kampionati.
10. Pjesëtarët e ekipit dhe publiku supozohet të shprehin suport për pilotët, por përdorimi i fjalorit agresiv dhe të papërshtatshëm do të sjelli penalizimin e atij piloti gjatë garës. Nëse gara është e ndaluar penalitetet do të jenë të njëjta me pikën "9".



11. Pilotët duhet të jenë të vetëdijshëm që vendimet do të merren nga Drejtori i Garës. Çdo formë e “hakmarrjes” në pistë do të ndëshkohet nga Drejtori i Garës.

Penalitetet:

Shkelja	Penalizimi
Perplasja dhe kontakti I karteve	Skualifikim
Defekte mekanike që rezultojnë në ngadalesim apo mos përfundim të gares	Force Madhore
Perplasje me pasojë ndalimin e kartit në gomë	Skualifikim
Ndryshim i perseriturit i trajektorës si pasojë e kontaktit të perseriturit	Paralajmerim, ndryshim pozicioni
Mos respektim i sinjalizimeve me flamur	Skualifikim
Shpejtimi pas përfundimit të gares dhe kalimit të vijës së finishit apo drejtimi në mënyrë të papërshtatshme me sigurinë e përgjithshme	Skualifikim
Çdo lloj agresioni verbal apo fizik midis pilotëve brenda apo jashtë ambienteve të pistës së kartingut	Skualifikim
Mos respektimi i një udhëzimi të zyrtarëve të gares	Skualifikim
Jump Start	Ndryshim një pozicion pas në renditjen
Përshpejtimi në zonën e ndalimit	Sipas vlerësimit të zyrtarëve të garës
Vonese në paraqitje për fillimin e gares	Sipas vlerësimit të drejtorit të gares

Ankesat dhe kontestimet:

1. Çdo ankesë mund të depozitohet tek gjyqtarët e garës vetëm nga përfaqësuesi i ekipit
2. Koha e depozitimit të ankesave është jo më vonë se 10 minuta nga shpallja e rezultateve paraprake
3. Për çdo ankesë të depozituar konkurrenti duhet të kryejë një pagesë prej 3'000 ALL